

MARRËVESHJE NDËRMJETËSIMI - QIRADHËNIE E HAPUR

Për ndërmjetësim pasurie të paluajtëshme

Në mbështetje të ligjit 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë " neni 659 e vijues, sot më datë ____/____/2019 me vullnet të lirë, lidhet kjo marrëveshje ndërmjetësimi ndërmjet palëve si më poshtë:

Z._____, i datëlindjes ____/____/____ në _____madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin (ID) Nr. _____dhe me nr kontakti +355 _____ (në vijim të kësaj marrëveshje Klienti)
Dhe

Agjensi Ndërmjetësimi Pronash të Paluajtshme, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Tiranës, me NIPT nr. _____, me seli në adresën: .Rr., Tiranë, përfaqësuar nga Z. madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën/ kartë identiteti nr.,

Neni I

OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1. Objekti i kësaj marrëveshje është ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimi nga agjensia për dhënien me qira të pronës së paluajtshme që klienti ka në pronësinë e tij.

1.2 Agjensia do të ofrojë shërbime ndërmjetësimi për dhënien me qira të pronës me specifikat e mëposhtme:

Lloji i Pronës _____ me sipërfaqje _____ m² Zona Kadastrale Nr. ____/____ me Nr Pasurie _____ Vol _____ Faqe _____ e ndodhur në adresën _____.

1.3 Cmimi i listuar i pronës do të jetë në vlerën _____.

1.4 Cmimi i përcaktuar në nenin 1.3 mund të ndryshojë me marrëveshje ndërmjet palëve në varësi të kushteve të tregut apo kërkesës.

Neni II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENSISË

2.1 Agjensia do të kërkojë në tregun e pasurive të paluajtshme për të gjetur një qiramarrës për pronën që klienti zotëron sikurse është përcaktuar në Nenin 1.2 të kësaj marrëveshje.

2.2 Agjensia do të marketojë pronën e klientit në të gjitha kanalet e marketimit që ajo përdor.

2.3 Agjensia do të trajtojë të gjithë informacionin e marrë nga klienti në mënyrë konfidenciale në përputhje me ligjin "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nuk do të kryejë asnjë veprim i cili mund të çënojë interesat e klientit.

2.4 Agjensia do të marrë pjesë në negocimin për nënshkrimin e marrëveshjes së qiradhenies së pronës së klientit, duke i shërbyer interesave të këtij të fundit.

2.5 Agjensia duhet të informojë klientin në mënyrë të vazhdueshme për procesin e qiradhenies apo marketimit të pronës.

Neni III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KLIENTIT

3.1 Klienti duhet t'i vendosë në dispozicion agjensisë çdo informacion dhe dokument të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të agjensisë sipas kësaj marrëveshje.

3.2 Klienti duhet të evitojë pjesëmarrjen personalisht apo nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, në vizitat e organizuara prej agjensisë për qiramarrësit potencial .

3.3 Klienti do t'i paguajë agjensisë shumën përkatëse sikurse parashikohet në këtë marrëveshje.

3.4 Për më tepër, unë, i nënshkruari, shprehimisht bie dakord dhe autorizoj Kontrolluesin që të mbledhë, ruajë, përdorë, përpunojë, përhapë dhe transferojë të Dhënat Personale tek autoritetet publike, gjyqësore dhe/ose agjensitë e zbatimit të ligjit sic kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Unë ruaj të drejtën që t'i kërkoj Kontrolluesit të më japë informacion nëse të Dhënat e mia Personale po përpunohen. Unë, i nënshkruari e jap pëlqimin lirisht, në dijeni të plotë dhe me vullnetin tim të lirë.

Neni IV

PAGESA DHE KUSHTET E PAGESËS

4.1 Për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, klienti do t'i paguajë agjensisë 1 (nje) qira mujore (bruto) për kontrata nga 0-3 vite. Për kontrata mbi 3 vite tarifa e shërbimit të agjensisë është 2 (dy) qira mujore (bruto).

4.2 Pagesa duhet të kryhet në ditën kur nënshkruhet kontrata e qiradhënies së pronës.

4.3 Klienti do të paguajë çmimin me transfertë bankare në llogarinë bankare të përcaktuar nga agjensia ose në një formë tjetër të rënë dakord nga palët.

4.4 Për pagesën e çmimit, agjensia do t'i lëshojë klientit faturat përkatëse.

4.5 Në rast se klienti nuk transferon çmimin në kohën e duhur, do t'i paguajë agjensisë një dëmshpërblim prej 0,2%(përqind) të shumës së rënë dakord në paragrafin 4.1, për çdo ditë vonesë.

4.6 Në rastin kur klienti, pronën për të cilën është njoftuar nga Agjensia se i është ofruar fillimisht një qiramarrësi potencial, nëpërmjet refuzimit, negocimit të drejtpërdrejtë me qiramarrësin ose në çdo mënyrë tjetër e cila synon të shmangë agjensinë, klienti detyrohet t'i paguajë agjensisë vlerën përkatëse për të cilën ishte rënë dakord më parë si dhe një shumë prej 25 %(përqind) të çmimit që detyrohet.

Neni V

AFATI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

5.1 Afati i kësaj marrëveshje është ____ (_____) muaj dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve.

5.2 Kjo marrëveshje ndërmjetësimi mund të zgjidhet nga klienti duke lajmëruar agjensinë të paktën 15 ditë përpara duke shpjeguar dhe arsyet përkatëse.

5.3 Klienti nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje nëse kanë filluar negociatat me një qiramarrës të mundshëm, negociata të cilat vërtetohen në mënyrë shkresore si kontratë kapari, kontratë rezervimi, kapar negocimi, apo cdo dokument tjetër. Në rast se klienti zgjidh kontratën ndërkohë që kanë filluar negociatat, të cilat konkludohen me nënshkrimin e kontratës dhe plotësimin e shërbimit nga ana e agjensisë, pavarësisht zgjidhjes së kontratës nga Klienti, ky i fundit detyrohet t'i paguajë agjensisë çmimin e përcaktuar në paragrafin 4.1 më sipër dhe një shumë prej 25% të çmimit që i detyrohet.

Neni VI

LIGJI I ZBATUESHËM

6.1 Kjo marrëveshje është përpiluar dhe do të interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

6.2 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të zgjidhen me negocie dhe në mënyrë miqësore ndërmjet tyre.

6.3 Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje brënda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e lindjes së mosmarrëveshjes, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.4 Kjo kontratë është përpiluar në dy kopje origjinale dhe është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve. Në prani të njëra - tjetrës, palët nënshkruajnë dhe vulosin këtë kontratë në datën e shënuar më lart.

AGJENSIA

KLIENTI
